



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 248/Prot.
F1

Datë 16/12 2022

VENDIM

Nr. 935, Datë 16.12.2022

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 839, datë 29.09.2021 nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 74, pika 1, germa (c), neni 75, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 839, datë 29.09.2021 nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK” (këtu e në vijim VKK nr. 839/2021);
- Pretendimeve të paraqitura nga ndërmarrjet:
 1. Agro Blend SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 344/9 prot., datë 07.12.2022, “Qëndrime mbi monitorimin e VKK nr. 839, datë 29.09.2021”;
 2. Miell Tirana SHA me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 248/66 prot., datë 07.12.2022, “Kthim përgjigje”;
 3. Bloja SHA me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 248/67 prot., datë 07.12.2022, “Vërejtje mbi materialin dërguar nga Autoriteti i Konkurrencës”;
 4. Atlas Mills SHPK me shkresat protokolluar pranë AK me nr. 248/47, datë 08.11.2022 “Sqarime paraprake për njoftim raportin e monitorimit nr. 248/40,

datë 03.11.2022” dhe nr. 248/68 prot., datë 07.12.2022, “Sqarime të shoqërisë Atlas”;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi pretendimet e paraqitura nga ndërmarrjet: Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK.

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 700/2020, “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU” (këtu e në vijim VKK nr. 700/2020), nëpërmjet pikave II, III, VI dhe VII, vendosi:
 - II. *Konstatimin e sjelljes së bashkënduar midis ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritimit vertikal, sjellje e cila bie në kushtet e zbatimit të nenit 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*
 - III. *Detyrimin e ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK si vijon:*
 1. *Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;*
 2. *Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;*
 3. *Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;*
 4. *Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK-së të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.*
 -
 - VI. *Moszbatimi i përmbushjes së pikës III të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.*
 - VII. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për një periudhë 1 (një) vjeçare.*
2. Për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të vendosura në VKK nr. 700/2020, Sekretariati i

Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të pikës VII të këtij Vendimi, ka monitoruar sjelljen e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, për periudhën 1 (një) vjeçare korrik 2020 - korrik 2021.

3. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 839, datë 29.09.2021, me arsyetimin se një vlerësim gjithëpërfshirës do ta çonte në krijimin e një opinionimi më të konsoliduar në lidhje me sjelljen e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, kërkoi një periudhë monitorimi më të gjatë sesa një vit, duke vendosur me shumicë votash:
 - I. *Detyrimin e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK:*
 - *Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;*
 - *Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;*
 - *Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;*
 - *Të aplikojnë kushte të barabarta tregtimi për veprime tregtare të njëjta ndaj subjekteve me të cilat hyjnë në marrëdhënie kontraktore të rrjedhës së poshtme të furnizimit me miell.*
 - II. *Detyrimin e Ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK të depozitojnë pranë AK-së për periudhën e monitorimit:*
 - *Raportim tre-mujor në lidhje me kostot e importit të grurit, kostot e miellit dhe çmimin e shitjes së miellit.*
 - *Raportim tre-mujor në lidhje me të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna.*
 - III. *Ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK të mbahen nën monitorim edhe për një vit tjetër kalendarik. Monitorimi përfundon një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.*
4. Vendimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 700, datë 24.07.2020 dhe nr. 839, datë 29.09.2021 janë vendime të formës së prerë, pasi nuk janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK.
5. Për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të vendosura në VKK nr. 839/2021, Autoriteti Konkurrencës, në zbatim të pikës III të këtij Vendimi, ka monitoruar sjelljen e ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, për periudhën 1 (një) vjeçare pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
6. Me qëllim realizimin e monitorimit në zbatim të VKK nr. 839/2021, bazuar në nenin 33

dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjatë periudhës së monitorimit është kërkuar informacion nga ndërmarrjet: AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

7. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, me shkresat: nr. 248/41 prot, datë 03.11.2022, drejtuar AgroBlend SHPK; nr. 248/42 prot, datë 03.11.2022, drejtuar Miell Tirana SHA; nr. 248/43 prot, datë 03.11.2022, drejtuar Atlas Mills SHPK; nr. 248/44 prot, datë 03.11.2022, drejtuar Bloja SHA, iu komunikoi ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK rezultatet e monitorimit, i ftoi ato në seancën dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës, për të parashtruar pretendimet e tyre lidhur me këto rezultate.
8. Në përgjigje të kërkesave të Komisionit të Konkurrencës, gjatë seancave dëgjimore të datës 07.12.2022 me ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, këto ndërmarrje paraqitën me gojë dhe me shkrim pretendimet e tyre mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të VKK nr. 839/2021, përkatësisht:
 - Agro Blend SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 344/9 prot., datë 07.12.2022, “Qëndrime mbi monitorimin e VKK nr. 839, datë 29.09.2021”;
 - Miell Tirana SHA me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 248/66 prot., datë 07.12.2022, “Kthim përgjigje”;
 - Bloja SHA me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 248/67 prot., datë 07.12.2022, “Vërejtje mbi materialin dërguar nga Autoriteti i Konkurrencës”;
 - Atlas Mills SHPK me shkresat protokolluar pranë AK me nr. 248/47, datë 08.11.2022 “Sqarime paraprake për njoftim raportin e monitorimit nr. 248/40, datë 03.11.2022” dhe nr. 248/68 prot., datë 07.12.2022, “Sqarime të shoqërisë Atlas”;

pretendime këto të cilat në respektim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

II. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve nën monitorim

9. Gjatë monitorimit të zbatimit të VKK nr. 839/2021 është ndjekur e njëjta metodologji e përdorur në raportin e hetimit të thelluar dhe monitorimit të zbatimit të VKK nr. 700/2020 për analizën e të dhënave të shitjeve mujore të depozituar nga ndërmarrjet për miellin nga gruri i zakonshëm.
10. Ndërmarrjet Bloja SHA, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Agrobend SHPK, që zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të importit dhe tregtimit të grurit janë ndërmarrjet që zotërojnë fuqi të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin në tregun e prodhimit të miellit. Këtij konstatimi i shtohet fakti që importuesit më të mëdhenj të grurit të integruar vertikalisht, kanë në zotërim linja prodhuese/përpunuese duke i krijuar vetes ekonomi të shkallës për të sjellë në treg miellin me kosto prodhimi sa më të ulët.
11. Nëpërmjet VKK nr. 700/2020 është konstatuar sjellja e bashkërenduar midis

ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregimit të miellit, pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritimit vertikal, sjellje e cila bie në kushtet e zbatimit të nenit 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

12. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 839, datë 29.09.2021 vendosi zgjatjen e periudhës së monitorimit të zbatimit të VKK nr. 700/2020 edhe për një periudhë 1 vjeçare.

13. Në zbatim të pikës I të VKK nr. 839/2021 është realizuar analiza e sjelljes së ndërmarrjeve Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA, nga ku rezulton se:

- *Për vitin 2021, ndërmarrjet kryesore importuese zënë respektivisht pjesët e tregut si vijon: Miell Tirana SHA me 24.3 % të sasisë së importuar, Agro Blend SHPK me 24 % të sasisë së importuar, Bloja SHA me 19.2 % të sasisë së importuar dhe Atlas Mills SHPK me 13.1 % të sasisë së importuar sipas sasisë së grurit të importuar. Ndërsa ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë tregu më të vogël se 2 % të sasisë së importuar të grurit.*
- *Për periudhën janar – korrik 2022, ndërmarrjet kryesore të importit të grurit janë ndërmarrja AgroBlend SHPK me pjesë tregu prej 27.14 % sipas sasisë së importuar, ndërmarrja Miell Tirana SHA me 21.37% të sasisë së importuar, ndërmarrja Bloja SHA me 18.93 % të sasisë së importuar dhe Atlas Mills SHPK me 14.65 % të sasisë së importuar. Ndërsa ndërmarrjet e tjera zënë nën 2.6 % të sasisë së importuar të grurit.*
- *Tregu i importit të grurit paraqitet një shkallë të moderuar përqendrimi, duke qenë se treguesi HHI është në vlerat 1,900 për vitin 2021 dhe 1,872 për periudhën janar - korrik 2022. Treguesi CR₃ është rreth 68 % për vitin 2021 dhe rreth 67% për periudhën janar – korrik 2022. Treguesi CR₄ është rreth 81 % për vitin 2021 dhe rreth 82% për periudhën janar – korrik 2022. Treguesit e përqendrimit paraqesin vlera të larta pasi janë 4 ndërmarrje që zotërojnë pjesën kryesore të importit të grurit dhe në treg operojnë një numër të konsiderueshëm importuesish me pjesë shumë të vogla tregu, nën 2 %.*
- *Referuar importit të grurit nuk ka ndarje të burimeve të furnizimit nga ndërmarrjet Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Bloja SHA dhe Miell Tirana SHA. Ky konkluzion bazohet në faktin që periudhat kohore e importeve të realizuara të grurit dhe çmimet CIF paraqiten të ndryshme për secilën ndërmarrje për vitin 2021 dhe periudhën janar - korrik 2022.*
- *Nga analiza e çmimeve të njëjta¹, rezulton se për vitin 2021, ndërmarrja AgroBlend SHPK ka 226 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 24,670,620 kg. Ndërmarrja Atlas Mills SHPK ka 203 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera për vitin 2021, ku*

¹ P.sh: Me “Çmime të njëjta”, në këtë analizë janë identifikuar ato çmime jashtëzakonisht të përafërta, deri në vlerën (+/- 0.05 Lekë).

për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 15,629,946 kg. Ndërmarrja Miell Tirana SHA ka 201 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera për vitin 2021, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 13,785,950 kg. Ndërmarrja Bloja SHA ka 108 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera për vitin 2021, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 4,533,578 kg.

- *Për periudhën janar - gusht 2022, ndërmarrja AgroBlend SHPK ka 107 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 11,011,628 kg. Ndërmarrja Atlas Mills SHPK ka 67 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera për periudhën janar - gusht 2022, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 8,134,250 kg. Ndërmarrja Miell Tirana SHA ka 134 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera për periudhën janar - gusht 2022, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 10,496,825 kg. Ndërmarrja Bloja SHA ka 86 çmime shitje të njëjta me ndërmarrjet e tjera, ku për këto çmime të njëjta ka realizuar shitje të miellit për bukë rreth 3,445,692 kg.*
14. Duke marrë në konsideratë elemente si burimet e ndryshme të furnizimit dhe çmimin e blerjes së grurit, teknologjitë e ndryshme të prodhimit të miellit, kostot e magazinimit dhe logjistikës, shpenzimet administrative, etj., dhe normat e ndryshme të fitimit, ndërmarrjet Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA nuk mund të rezultojnë me çmime të njëjta të shitjes së produktit.
 15. Përsa më sipër vlerësohet se katër ndërmarrjet Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA kanë aplikuar çmime të njëjta shitje, por numri total i çmimeve të njëjta të shitjes të aplikuara të cilat janë marrë në analizë kanë ardhur në rënie duke krahasuar vitin 2021 me periudhën janar - gusht 2022. Gjithashtu në rënie janë dhe përqindjet e vlerës së shitur të realizuara me çmimet në analizë nga ndërmarrjet sëbashku, ku për gjysmën e parë të viti 2021 kjo vlerë e shprehur në përqindje ka variuar midis 80-90 %, për gjysmën e dytë të vitit 2021 kjo vlerë ka variuar midis 54-83 %, për periudhën janar - mars ka variuar midis 65 – 71%, ndërsa për periudhën prill – gusht 2022 e cila korrespondon me hyrjen në fuqi të vendimeve të Bordit të Transparencës ka variuar midis 66 – 75 %.
 16. Si rezultat i analizës konkludohet se ndërmarrjet Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA kanë aplikuar në vazhdimësi çmime të njëjta shitje edhe në periudhën shtator 2021 - gusht 2022, duke mos zbatuar detyrimin e dhënë në pikën I të VKK nr. 839/2021, sjellje kjo e cila, në kuptim të nenit 74, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 9121/2003, përbën shkelje të rëndë të konkurrencës dhe gjobitet në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës.
 17. Në zbatim të pikës II të VKK. 839/2021, ndërmarrjet Agroblend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK kanë detyrimin që, për periudhën e monitorimit, të depozitojnë pranë AK-së:
 - Raportim tre-mujor në lidhje me kostot e importit të grurit, kostot e miellit dhe çmimin

- e shitjes së miellit;
- Raportim tre-mujor në lidhje me të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna.
18. Nga vlerësimi i informacionit të depozituar nga ndërmarrjet Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA, në përmbushje të detyrimit të mësipërm, rezulton se:
- Ndërmarrja Bloja SHA nuk ka paraqitur koston e prodhimit të produktit miell për periudhën prill – gusht 2022, duke mos paraqitur të plotë informacionin e kërkuar në pergjigje të kërkesave tona për informacion;
 - Ndërmarrja Agroblend SHPK për sa i përket informacionit rreth koston mesatare të prodhimit të miellit paraqet vlera të ndryshme të koston të prodhimit të miellit për të njëjtën periudhë në dy shkresa të ndryshme duke sjellë të dhëna të pasakta;
 - Ndërmarrjet Atlas Mills SHPK dhe Miell Tirana SHA kanë zbatuar pikën II të VKK nr. 839/2021, duke sjellë informacionin e kërkuar.
19. Në lidhje me zbatimin e pikës II të VKK nr. 839/2021, rezulton se ndërmarrjet Agroblend SHPK dhe Bloja SHA, nuk kanë zbatuar detyrimin e dhënë sipas pikës II të VKK nr. 839/2021 lidhur me raportimet tre mujore mbi kostot e produktit miell.
20. Si konkluzion, nga monitorimi i zbatimit të VKK nr. 839/2021, konstatohet se:
- Ndërmarrjet Agroblend SHPK, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA kanë aplikuar në vazhdimësi çmime të njëjta shitje edhe në periudhën shtator 2021 - gusht 2022, duke mos zbatuar detyrimin e dhënë në pikën I të VKK nr. 839/2021;
 - Ndërmarrjet Agroblend SHPK dhe Bloja SHA, nuk kanë zbatuar detyrimin e dhënë sipas pikës II të VKK nr. 839/2021 lidhur me raportimet tre mujore mbi kostot e produktit miell.
21. Me aktin normativ nr. 7, datë 18.03.2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg” u krijua Bordi i Transparencës, i cili miraton listën e produkteve ushqimore bazë që do të monitorohen dhe marzhet që do të aplikohen për këto produkte. Ky bord, nga muaji prill e në vijim ka përcaktuar marzhin e fitimit sipas hallkave të tregtimit, pra praktikisht çmimet maksimale të cilat do të aplikohen për produktet bazë dhe jo çmime të fiksuara. Në një situatë normale, çmimet e rekomanduara, ashtu si edhe ato të fiksuara mund të kenë efekte negative në konkurrencë. Çmimet e rekomanduara mund të ndihmojnë koordinimin e çmimeve midis konkurrentëve si pasojë e transparencës dhe mund të çorientojnë konsumatorët rreth nivelit të arsyeshëm të çmimit. Çmimet e fiksuara janë instrumente rregullatorë, por që kanë efekte dëmtesues për konkurrencën, reduktojnë seriozisht përfitimet e konsumatorëve që janë rezultat i konkurrencës së tregut. Gjithashtu çmimet maksimale të fiksuara mund të mbrojnë konsumatorin nga çmime të larta në treg, por krijojnë një mungesë të konkurrencës efektive.

22. Sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi dhe përlllogaritjen e masës së gjobës ka marrë në konsideratë pretendimet e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, si dhe situatën e veçantë të krijuar në treg që nga viti 2020, fillimisht për shkak të situatës epidemike të krijuar nga COVID-19 dhe më pas lufta në Ukrainë (shkurt 2022). Bordi i Transparencës që nga muaji prill e në vijim përcaktoi marzhin e fitimit sipas hallkave të tregtimit, për produktin miell masiv për prodhimin e bukës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 45, nenin 74, pika 1, gërma (c), dhe nenin 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,






VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 839, datë 29.09.2021 nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK.
- II. Detyrimin e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktikat të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg vecanërisht:
 - a) të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b) të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c) të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- III. Gjykitjen e ndërmarrjes Agro Blend SHPK për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I dhe II të VKK nr. 839/2021, në masën 5,774,395 (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë.
- IV. Gjykitjen e ndërmarrjes Bloja SHA për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I dhe II të VKK nr. 839/2021, në masën 1,468,877 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë) Lekë.

- V. Gjobitjen e ndërmarrjes Miell Tirana SHA për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I të VKK nr. 839/2021, në masën 2,025,659 (dy milion e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) Lekë.
- VI. Gjobitjen e ndërmarrjes Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I të VKK nr. 839/2021, në masën 1,324,390 (një milion e treqind e njëzet e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë) Lekë.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Adriana BERBERI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar	
--	--	---	--	--

Denar BIBA

